| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Universiteti:** | **Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren** |
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit** |
| **Programi studimor:** | **Menaxhim në agrobiznes** |
| **Titulli i lëndës:** | **Ekonomiksi i bujqësisë dhe industrisë ushqimore** |
| **Niveli:** | **Master** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative (O)** |
| **Viti i studimeve / semestri:** | **Viti 1 / Semestri 1** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3 + 2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **7** |
| **Koha / lokacioni:** | **Do të shpallet** |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | **Dr. Sc. Nol Krasniqi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **nol.krasniqi@uni-prizren.com; +383 44 702 505** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Ky kurs ofron studentëve njohuritë, kuptimin dhe analizimin e ekonomikist të bujqësisë dhe industrisë ushqimore, ekuilibrin i forcave të tregut, i cili është çelësi për të kuptuar ekonominë e industrisë ushqimore dhe adresimin e problemeve të tilla si alokimi i prodhimit midis produkteve konkurruese, tregtia ndërrajonale, magazinimi optimal etj. Kursi shqyrton gjithashtu shkaqet, ashpërsinë dhe efektet e varfërisë së vazhdueshme, rritjes së shpejtë të popullsisë dhe kequshqyerjes në vendet në zhvillim. Diskuton dhe analizon zgjidhjet e mundshme për këto probleme dhe merr parasysh implikimet e globalizimi për bujqësinë, varfërinë dhe mjedisin. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i këtij kursi është që studentët të kuptojnë dhe analizojnë problemet e zhvillimit të ekonomisë bujqësore dhe industrisë ushqimore. Vëmendje të theksuar, kursi i kushton zhvillimit të shkathtësive të studentëve për të analizuar shfrytëzimin racional të resurseve të kufizuara natyrore dhe zbatimin e politikave makro dhe mikro ekonomike që sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë agro-ushqimore. Kursi do të përgadisë studentët për të analizuar industrinë ushqimore, duke adaptuar qasjen nga ferma deri te tryeza e kuzhines. Njëkohësisht, kursi ka për qëllim të trajtoj ekonominë dhe menaxhimin e firmave të përpunimit të ushqimit, duke përfshirë edhe analizën e zingjirit të ofertës së ushqimit (prodhuesit, shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njëkohësisht, kursi ka për qëllim të ofroj njohuri të avancuara zhvillimin e tregtisë së jashtme dhe flukseve ndërkombëtare të kapitalit. Përfundimisht, kursi ka për qëllim trajtimin e temave që lidhen me qëndrueshmërinë e mjedisore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të kursit, studentët do të jetë në gjendje të:<br>▪ Analizojnë dhe diskutojnë teoritë e zhvillimit të ekonomisë së bujqësisë<br>▪ Analizojnë dhe kuptojnë dimensionet e ofertës dhe kërkesës për ushqim në nivel lokal dhe botëror<br>▪ Analizojnë procesin e bashkëveprimit të kërkeses dhe ofertës së produkteve agro-ushqimore<br>▪ Vlerësojnë teoritë dhe praktikat e bujqësisë dhe industrisë ushqimore<br>▪ Analizojnë dhe hulumtojnë strategjitë e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë ushqimore<br>▪ Vlerësojnë zhvillimin e bujqësisë, tregtisë ndërkombëtare si dhe politikat dhe marrëveshjet tregtare.<br>▪ Zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar mbi bazat e industrisë ushqimore, ekonomiksit të çmimeve për përpunuesit e ushqimit. | | |
| | | | |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 3 | 13 | 39 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 13 | 26 |
| Punë praktike | 1 | 3 | 3 |
| Kontaktet me mësimdhënësin (konsultimet) | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | 0 | 3 | 0 |
| Kollokviume, seminare | 1 | 1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 13 | 13 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 2 | 8 | 16 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezentimet etj. | 3 | 1 | 3 |
| **Totali** | | | 150 |
| | | | |
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provimi përfundimtar. | | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%,<br>Provimi i ndërmjemë (kollokviumi): 20%,<br>Projekti i kursit: 10%,<br>Provimi final: 60%, | | |
| | | | |

| | |
|---|---|
| **Literatura bazë:** | Norton, G.W., Alwang, J., Masters, W.A. (2010). Economics of Agricultural Development. Routledge<br>Jeffrey H. Dorfman (2014). Economics and Management of the Food Industry. Routledge |
| **Literatura shtesë:** | Douglas D. Southgate, Jr., Douglas H. Graham, Luther G. Tweeten (2010). The World Food Economy. John Wiley & Sons, Inc.<br>Barkley, Andrew, Paul W. Barkley (2013). Principles of Agricultural Economics. Routledge<br>Barkley, Andrew (2019). The Economics of Food and Agricultural Markets. NPP eBooks. |
| | |
| **Java** | |
| ***Java e parë:*** | Hyrje në dimensionet e problemit botëror të ushqimit dhe zhvillimit. Ekonomiksi i kërkesës për ushqim, Popullsia |
| ***Java e dytë:*** | Teoritë e Zhvillimit dhe Roli i Bujqësisë (Transformimi dhe Rritja Ekonomike, Strategjia e Teorisë së Zhvillimit) |
| ***Java e tretë*:** | Sistemet bujqësore dhe përdorimi i burimeve. (Bujqësia në shoqëritë tradicionale. Përdorimi i burimeve dhe qëndrueshmëria Burimet njerëzore, Struktura familjare dhe rolet gjinore) |
| ***Java e katërt:*** | Teoritë dhe Strategjitë për Zhvillimin e Bujqësisë (Hulumtimi, Sherbimet Këshillimore dhe Edukimi) |
| ***Java e pestë:*** | Tregjet e Tokës dhe të Punës, Tregjet e hyrjes dhe kredisë Politikat e çmimeve dhe sistemet e marketingut. |
| ***Java e gjashtë*:** | Bazat e Industrisë Ushqimore |
| ***Java e shtatë:*** | Ekonomiksi i kostos për impiantet e përpunimit. Ekonomiksi i çmimeve për përpunuesit e ushqimit |
| ***Java e tetë:*** | Provimi i ndërmjemë (Kollokviumi). |
| ***Java e nëntë:*** | Ekonomiksi i magazinimit, Marrja e vendimeve për vendndodhjen dhe madhësinë e impiantit |
| ***Java e dhjetë:*** | Konkurrenca e papërsosur dhe teoria e lojërave. Kuptimin e teorisë së lojërave si një nën-disiplinë brenda ekonomisë që studion vendimmarrjen në një mjedis konkurrues. |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | Industria e shërbimit ushqimor, shitësit dhe tregtarët e ushqimit |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Zhvillimi dhe lancimi i një produkti të ri. Karakteristikat e veçanta organizative në industrinë ushqimore. |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Bujqësia dhe Tregtia Ndërkombëtare, Politikat tregtare, negociatat dhe marrëveshjet tregtare. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Politikat Makroekonomike dhe Zhvillimi Bujqësor, Rrjedhjet e kapitalit, ndihma e huaj dhe ndihma ushqimore |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve. |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| ▪ Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës.<br>▪ Studenti duhet të respektojë orarin e ligjeratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm.<br>▪ Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare,<br>▪ Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi.<br>▪ Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve. |

## Ushtrimet

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ushtrimet që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | Shpërndarja e temave të projekteve seminarike. |
| ***Java e dytë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës parë të ligjëratave. |
| ***Java e tretë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dytë të ligjëratave. |
| ***Java e katërt:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tretë të ligjëratave. |
| ***Java e pestë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës katërt të ligjëratave. |
| ***Java e gjashtë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës pestë të ligjëratave. |
| ***Java e shtatë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës gjashtë të ligjëratave. |
| ***Java e tetë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës shtatë të ligjëratave. |
| ***Java e nëntë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tetë të ligjëratave. |
| ***Java e dhjetë:*** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës nëntë të ligjëratave. |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës njëmbëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dymbëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës trembëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve. |